

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.16.04.2021*

**16.04.2021  
Ora 12:30**

**RENDI I DITËS**

**“Shorti për përcaktimin e relatorëve për kërkesat ankimore nr.12, 13, 14”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto.**
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Atëhere përshëndetje! Jemi këtu për të zhvilluar seancën e shortit për përcaktimin e relatorëve për tre kërkesat ankimore që janë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kërkesa Ankimore nr.12 me ankues Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ankimon vendimin e Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve me nr.224 dt.13.04.2021 për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore për periudhën 26.03.2021-03.04.2021. Kërkesa ankimore është paraqitur në gjykatë në dt.15.04.2021 në orën 17:25. Kërkesa e dytë ankimore është paraqitur në dt.16.04.2021 në orën 11:10 dhe ankuesi është Aleanca Për Mbrojtjen e Teatrit, e cila ankimon vendimin... shqyrtimin e ankesës së Aleancës Për Mbrojtjen e Teatrit ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kërkesa ankimore nr.14 është me ankues Kryetarin e Bashkisë së Vorës Z. Gentian Picari, për të cilin u shpall vendimi nr.234, dt.14.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për sanksionin administrativ, ligjor ndaj Z. Gentian Picari, Kryetar i Bashkisë Vorë me shumën 10.000 (dhjetë mijë) lekë për moszbatimin e vendimit nr.140, dt.15.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas procedurave të rregullores së KAS-it kemi përgatitur 5 shirita letre, në të cilat është vendosur numri i ankimit administrativ nr.12,13,14 dhe 2

**Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.16.04.2021*

shirita letre janë të bardhë dhe pa shënime. Këto shirita janë vendosur në gogla me ngjyrë, formë të njëjtë, në një enë transparente. Pasi palosen letrat që kanë numrin e ankimit administrativ, futen në gogla me ngjyrë, formë të njëjtë. Atëhere, një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke qenë se asnjë nga anëtarët e KAS-it nuk është i pranishëm, do të tërheqi duke filluar nga rendi alfabetik ngjithësisht të anëtarëve të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve. Vazhdojmë me emrin e parë, Z. Elvin Lako. Hapet gogla në emër të Z. Lako. Atëhere rezultati i shortit për Kërkesën Ankimore nr.12 me ankimues Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet është Z. Elvin Lako. Vazhdojmë me emrin tjetër, Z. Elvis Çefa. Hapet gogla për Z. Elvis Çefa dhe rezulton se shiriti i letrës është i bardhë dhe pa shënime. Vazhdojmë me emrin tjetër, Z. Ilirjan Rusmali. Pasi trazojmë goglat, hapet gogla në emër të Z. Rusmali, e cila rezulton se është kërkesa ankimore me nr.13, me ankimues Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, relator Z. Ilirian Rusmali. Vazhdojmë me hedhjen e shortit në emër të Z. Koli Bele. Trazojmë goglat, hapet gogla dhe rezulton kërkesa ankimore nr.14 me ankues Kryetarin e Bashkisë Vorë, Z. Gentian Picarin. Do të jetë relator Z. Koli Bele për kërkesën ankimore nr.14. Vazhdon procedura, pasi hapet dhe gogla e fundit, rezulton se shiriti është i bardhë dhe pa shënime. Në përfundim të rezultatit të shortit, Kërkesa Ankimore nr.12, relator Z. Elvin Lako, kërkesa ankimore nr.13, relator Z. Ilirjan Rusmali dhe kërkesa ankimore nr.14, relator Z. Koli Bele, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

